



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.85, datë 28.06.2021

PËR
SISTEMIMIN E MJETEVE NË RUAJTJE TË TË ARDHURAVE NGA KUOTA E
GARANCISË PËR ÇERDHET DHE KOPSHTET

Në zbatim të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Të ardhurat, që arkëtohen nga kuotat e caktuara si mjet garancie regjistrimi i fëmijëve në kopshte dhe çerdhe publike të sistemohen në llogarinë e Thesarit “mjete në ruajtje”, pjesë e të ardhurave të Qendrës Ekonomike të Arsimit. Këto të ardhura do të derdhen nëpërmjet faturës për arkëtim të lëshuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit për bankat e nivelit të dytë

2. Kthimi i kësaj shume do të bëhet kur fëmija të largohet nga çerdhja ose kopshti publik duke marrë në konsideratë detyrimin debitor që fëmija ka.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461/prot.
13



Durrës, më 06.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 85 datë 28.06.2021 “Për sistemimin e mjeteve në ruajtje të të ardhurave nga kuota e garancisë për çerdhet dhe kopshtet”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

